

AKT THEMELIMI



I SHOQERISE "KONTAKT" SHPK.

NENI 1.

Luan LEKA, person fizik shqiptar, i datëlindjes 06/01/1954, me adrese banimi, rruga Muhamet Gjollësia, Pallati 69, Shk.1, Ap 4, me Pasport Nr. EV 200440 i nisur nga dëshira për të zhvilluar veprimtari private, ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin Nr. 7638 dt. 19. 11. 1992 "Për shoqëri tregëtare".

NENI 2.

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e statutit që i bashkëlidhet këtij Akt Themelimi.

NENI 3.

Emri i shoqërisë është "KONTAKT" Shpk.

NENI 4.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- ◆ Projektim, ndertim dhe supervizion te objekteve publike, industriale, turistike, bujqesore, rruga dhe ura etj., ne perputhje me licensen e dhene nga organi kompetent.
- ◆ Prodhim te materialeve dhe lendeve te para te ndertimit.



- ◆ Import-eksport me shumice dhe pakice te lendeve te para , materiale ndertimi, paisje e makineri e pjese kembimi per to.
- ◆ Import-eksport me shumice dhe pakice, te artikujve te konsumit te gjere. te industrise ushqimore, blegtorale, bujqesore etj.
- ◆ Konsulence teknike ne fushen e manaxhimit, ndertimit, tregtise ushqimore, industrise mekanike, politikave te punesimit, formimit profesional, pagave, sigurimeve dhe mbrojtjes shoqerore.

NENI 5.

Ne mbledhjen e pare te tij, Ortaku I Vetem I ka emeruar si administrator te shoqerise z. Ili FENDO, I biri I Irfanit, lindur ne Tirane me 19/05/1964, banues ne Tirane me adrese Rruga Mihal Duri, nr.125.

NENI 6

Qendra dhe selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranës, rruga Muhamet Gjollësia Pall.69,Shk. 1,Ap.4.

Ajo mund te hapë filiale apo degë ne të gjitha rrethet e vendit, si dhe jashte vendit.

NENI 7.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 Leke.

Ai eshte i ndare ne 100 pjesë ku sejcila pjesë ka një vlerë prej 1000 Leke, të renditura nga numuri 1 deri ne 100 të cilat janë krejtësisht të shlyera nga shoqeria.

Ortaku i Vetëm ka të drejtën e zmadhimit apo të zvogelimit të kapitalit themeltar të shoqerise nepermjet zmadhimit apo zvogelimit të pjesëve të kapitalit themeltar.



NENI 8.

Viti financiar, shpërndarja e fitimit të shoqërisë, punësimi, kompetencat, prishja e shoqërisë para kohe, likuidimi dhe kushtet e tjera përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

NENI 10.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në qytetin e Tiranës sot më dt. 02/06/1999.

ORTAKU I VETEM

LUAN LEKA



STATUTI

I SHOQERISE “ KONTAKT ” SHPK

I. KRIJIMI DHE FORMA E SHOQERISE

NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është krijuar nga Z. Luan LEKA, person fizik shqiptar, lindur në Tiranë me 06/01/1954, me adrese banimi, rruga Muhamet Gjollësja, Pallati 69, Shk 1, Ap. 4, me Pasport Nr. EV 200440, i cili në këtë shoqëri është “Ortak I Vetëm”, në përputhje me ligjin nr. 7638 datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”.

NENI 2

Shoqëria “ KONTAKT ” SHPK është një shoqëri tregtare dhe veprimtarinë e saj ekonomike e zhvillon në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e këtij statuti.

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar si person juridik.



II. EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 3


Emërtimi i plotë i shoqërisë është “ KONTAKT ” SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar).

III. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objektivi i veprimtarisë së shoqërisë është:

- ◆ Projektim, ndertim dhe supervizion të objekteve publike, industriale, turistike, bujqesore, rruga dhe ura etj., në përputhje me licencën e dhënë nga organi kompetent.
- ◆ Prodhim të materialeve dhe lendeve të para të ndertimit.
- ◆ Import-eksport me shumice e pakice të lendeve të para, materiale ndertimi, pajisje e makineri e pjesë këmbimi për to.
- ◆ Import-eksport me shumice dhe pakice të artikujve të konsumit të gjërë, të industrisë

- 
- ◆ Konsulencë teknike në fushën e menaxhimit, ndertimit, tregtisë ushqimore, industrisë mekanike, politikave të punësimit, formimit profesional, pagave, sigurimeve dhe mbrojtjes shoqërore.

IV. SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 5

Qendra e veprimtarisë së shoqërisë është në qytetin e Tiranës. Ajo ka të drejtë të hapë filiale apo degë në të gjitha rrethet e vendit apo jashtë vendit.

Selia e shoqërisë është me adresë: rruga Muhamet Gjollësja, Pall. 69, Shk. 1, Ap.4, Tirane.

Shoqëria ka vulën e saj, ku mbi të është i shkruajtur emëri i vetë.

Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë kohe mbi 10 vjetë, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj si perso juridike. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rast se shoqëria prishet para kohe.



V. KAPITALI THEMELTAR, KONTIBUTI

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke.

Ai është i ndarë në 100 pjesë ku secila pjesë ka një vlerë prej 1000 Leke të renditura nga numuri 1 deri në 100 të cilat janë krejtësisht të shlyera nga shoqëria.

Ortaku i Vetëm ka të drejtën e zmadhimit apo të zvogëlimit të kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet zmadhimit apo zvogëlimit të pjesëve të kapitalit themeltar.

NENI 8

I gjithë kontributi për formimin e kapitalit themeltar të shoqërisë përbëhet në para të shlyer tërësisht nga shoqëria dhe është derdhur nga Z. Luan LEKA i cili është dhe "Ortak i Vetëm" i saj.

Kapitali themeltar është derdhur në Bankën Italo Shqiptare në Tiranë e cila vërtetohet nëpërmjet një dokumenti bankar.

VI. PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 9

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme, me rrugë trashëgimie, në rast ndarjeje pasu. Është me bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve e pasardhësve.



NENI 10


Pjesët e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen edhe personave të tjerë që nuk bëjnë pjesë në këtë shoqëri, por me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar gjithmon duhet të vërtetohet me akt noterial.

VII. MARRJA E VENDIMEVE

NENI 12



Ortaku i Vetëm i shoqërisë përballon humbjen e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij të derdhur për formimin e kapitalit themeltar.

NENI 13

Të gjitha vendimet e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm. Vendimet e tij evidencohen në një regjistër i cili qëndron në selinë e shoqërisë.

VIII. ADMINISTRIM, KOMPETENCAT DHE KONTROLI

NENI 14

Shoqëria do të administrohet nga administratorë të cilët duhet të jenë persona fizik, megjithatë ajo mund të administrohet edhe nga ortaku i saj.

Në këtë shoqëri si administrator i saj është emëruar **Z. Ilir FINDO**, person fizik shqiptar, I biri Irfanit, lindur ne Tirane me 19/05/1964, banues ne qytetin e Tiraes me adrese, rruga Skenderbej, Pall 79, Shk. 8, Ap. 3.

NENI 15

Në marrëdhënie me Ortakun, administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer veprimet e administratimit të shoqërisë në interes dhe në emër të saj, nëpërmjet kompetencave që i janë caktuar në këtë statut ose nëpërmjet kompetencave që i delegon Ortaku i Vetëm nëpërmjet një prokure.

NENI 16

Administratori është përgjegjës individualisht apo solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të dispozitave të statutit apo për faje gjatë administrimit të shoqërisë

NENI 17

Disa nga kompetencat që ky statut i jep administratorit janë:

- të siguroj drejtimin e mirë të shoqërisë;
- të administroj pasurinë e shoqërisë dhe mjetet financiare të saj brenda kompetencave të lejuara nga Ortaku i Vetëm.
- të përfaqësoj shoqërinë në marrëdhënie me të tretët kryen veprime juridike me ta si dhe nënshkruan kontrata, kryen veprime bankare e financiare brenda kufirit të lejuar nga Ortaku i Vetëm.
- të përfaqësoj shoqërinë para organeve gjyqësore ose autorizon persona të tjerë kompetent
- i propozon Ortakut të Vetëm strukturën e shoqërisë dhe numrin e punonjësve që duhet të ketë ajo.
- i propozon Ortakut të Vetëm hapjen e filialeve apo degëve të shoqërisë
- merr masa që brenda 3 muajve të parë të vitit pasardhës nxjerr bilancin e vitit të kaluar

Administratori i shoqërisë ka edhe kompetenca të tjera të cilat Ortaku i Vetëm ja delegon nëpërmjet një prokure.

NENI 18

Disa nga vendimet e Ortakut të Vetëm të shprehura në këtë statut janë:

- vendos për shtimin e kapitalit themeltar, dhe miraton hapjen e degëve apo filialeve të shoqërisë
- miraton programin ekonomik të shoqërisë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë;
- emëron dhe shkarkon ekspertin kontabël;
- vendos për strukturën e shoqërisë dhe numrin e punonjësve të saj;
- vendos për mbylljen para kohe të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm ka dhe të gjitha kompetencat e tjera që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë të cilat nuk janë të përcaktuara në këtë statut. Gjithashtu ai ka dhe ato kompetenca që ushtron Asambleja e Ortakëve të përcaktuara në ato shoqëri dhe me më shumë se një ortak të vetëm dhe në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare.

NENI 19

ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomike financiare të shoqërisë caktohet një ekspert kontabël i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i Vetëm i saj.

IX. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

NENI 20

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht viti i parë financiar fillon në ditën e regjistrimit të saj dhe përfundon më 31 Dhjetor të vitit 1999.

NENI 21

Llogaritë vjetore, raportet mbi veprimtarinë e vitit financiar dhe raportet e vecanta të përgatitura nga administratori, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë brenda datës 6/mujorit të parë.

NENI 22

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

NENI 23

Fitimi netto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten shpencimet e realizuara, ortaku i vetëm vendos për qëllimin e përdorimit të tij si, për nxitjen ekonomike të shoqërisë, për investime, për reklamën tregëtare, për krijimin e fondit rezervë të shoqërisë etj.

NENI 24

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit dhe të disponimit të pasurisë së saj në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë së miratuar.

NENI 25

Shoqëria siç përgjigjet për detyrimet sipas dispozitave ligjore në fuqi, gëzon dhe të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen e saj nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 26

Detyrimet që shoqëria i krijon të tretëve gjatë veprimtarisë së saj ekonomike, ajo i mbulon nga fondi i rezervë, nga fonde të tjera ose nga shumat suplementare që mund të derdhë Ortaku i Vetëm.

X. PUNESIMET NE SHOQERI

NENI 27

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike ndërmjet të punësuarve dhe shoqërisë do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës individuale apo kolektive, në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

NENI 28

Shoqëria merr përsipër të derdhë rregullisht të gjitha detyrimet ligjore në kohën e duhur dhe për të punësuarit të bëjë derdhjet e kontributeve të dëgjimeve sipas kërkesave të legjislatcionit në fuqi.

XI. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

NENI 29

Shoqëria prishet para kohe kur:

- aktiviteti ekonomik i saj për një kohë të gjatë është me humbje;
- për arsye të parashikuara me ligj;
- në çdo rast tjetër kur Ortaku i Vetëm e shikon të arësyeshme prishjen e saj.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e marrjes së vendimit për prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi Ortaku i Vetëm cakton një ose disa likuidator të cilët i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit të shoqërisë dhe mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit.

Vetëm mbas pagimit të kreditorëve, likuiduesi i kalon kapitalet e mbetura Ortakut të Vetëm

XII. KUSHTE TE TJERA

NENI 30

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 31

Shpëtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri kolektive ose shoqëri anonime kryhet në vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore për shoqëritë tregtare.


NENI 32

Ky statut është hartuar në qytetin e Tiranës, sot më datën ,02/06/1999.

PER SHOQERINE " KONTAKT " SHPK

ORTAKU I VETEM

LUAN LEKA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 2711 REP.
NR. 200 KOL.

VERTETIM

02/06/1999

Sot, më dt. ~~4 10/1/1999~~, para meje, noteres, u paraqit personalisht Ortaku i Vetëm i shoqërisë " KONTAKT " Shpk, Z. Luan LEKA, I datëlindjes 06/01/1954, me adresë banimi, Rruga Muhamet Gjollësia, Pall 69, Shk 1, Ap.1 Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e tij u sigurova nga Pasaporta që mbante me numur EV 200440, i cili më deklaroi së është dakort me sa më sipër dhe e nëshkroi atë rregullisht dhe, unë Notere e vërtetova atë sipas ligjit.

PULLE TAKSE

RUHQIT

NOTERE
KENDIE
14/06/1999

